



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 01 nëntor 2011
Nr. ref.: RK146/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rasti nr. KI 40/11

Parashtruesi

Zef Prenaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Udhëzimit Administrativ Nr. 11/2010 për
pagesën e pensionit themelor, të nxjerrë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies
Sociale në tetor të vitit 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Zef Prenaj, avokat i pensionuar nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Udhëzimin Administrativ Nr. 11/2010, të cilën e ka nxjerrë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejshëm: MPMS) në tetor të vitit 2010, për lajmërimin, suspendimin, riaktivizimin, riaplikimin dhe ndërprerjet e pagesave të pensionit themelor pas vdekjes së pensionistit (në tekstin e mëtejshëm: Udhëzimi Nr. 11/2010).

Baza juridike

3. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

4. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) më 22 mars 2011.
5. Më 8 prill 2010, Kryetari e emëroi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues si dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Ivan Čukalović (kryesues), Enver Hasani dhe Iliriana Islami.
6. Më 24 mars 2011, Gjykata kërkoj nga parashtruesi i kërkesës që të ofronte informacione shtesë në lidhje me përfaqësimin e të gjithë pensionistëve të Kosovës nga ana e tij si dhe për shterjen e mjeteve tjera juridike, nëse kishte shterur fare ndonjë mjet juridik.

Përshkrimi i fakteve të rastit

7. Parashtruesi i kërkesës u pensionua më 10 maj 2007, kur i kishte përmbushur kushtet e parapara me ligjin e zbatueshëm, 40 vjet stazh pune dhe moshën 65 vjet.
8. Më 28 janar 2011, kur parashtruesi i kërkesës shkoi në bankën Raiffeisen për të marrë pensionin e vërejtë se pensioni nuk ishte paguar në llogarinë e tij, sikurse paguhej zakonisht.
9. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës konstatoi se i ishin paguar 2.120 euro për periudhën 38 mujore, ndërsa Departamenti i Administratës Pensionale pranë MPMS-së është dashur t'ia paguajë 3.040 euro, një diferencë prej 820 eurosh.
10. Për këtë arsye, parashtruesi i kërkesës u ankua në Departamentin e Administratës Pensionale me kërkesën që t'i paguhet në llogarinë e tij shuma prej 820 eurosh, duke përfshirë interesin e grumbulluar.
11. Më 11 shkurt 2011, Departamenti i Administratës Pensionale u përgjigj duke theksuar se ishin respektuar të gjitha procedurat në lidhje me pagesën e pensionit, në pajtim me Udhëzimin Administrativ.

Argumentet juridike të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës

12. Parashtruesi i kërkesës argumenton se, “në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neneve 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese”, ka “shkelje të Kushtetutës dhe të të drejtave të njeriut të të gjithë pensionistëve të Kosovës”.

13. Parashtruesi i kërkesës konkludon se, “Gjykata Kushtetuese duhet ta analizojë nga afër këtë (...) Urdhëresë Administrative 11/2010 dhe të njëjtën ta shpallë të pavlefshme dhe jokushtetuese, në mënyrë që të gjithë pensionistëve të Kosovës t’u paguhen pensionet që u janë mohuar deri më tani”.
14. Parashtruesi i kërkesës më tej konkludon se, “Urdhëresa Administrative Nr. 11/2010 është jokushtetuese dhe e paligjshme, jonjerëzore dhe në kundërshtim me të drejtat elementare të pensionistëve dhe me humanizmin në përgjithësi”.
15. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës propozon që Gjykata Kushtetuese “duhet të veprojë në përputhje me kërkesën tonë [e tij] në mënyrë që të gjithë pensionistëve të Kosovës t’u paguhen pensionet që janë pezulluar pa asnjë bazë ligjore”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

16. Kushtet e pranueshmërisë janë të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.
17. Nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës vendosin kornizën e përgjithshme juridike që kërkohet për pranueshmërinë e kërkesave individuale. Kjo kornizë parashikon që:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

18. Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës kërkon “vlerësim të kushtetutshmërisë të Udhëzimit Nr. 11/2011”, duke propozuar që, “Gjykata Kushtetuese duhet ta analizojë nga afër këtë (...) Urdhëresë Administrative 11/2010 dhe të njëjtën ta shpallë të pavlefshme dhe jokushtetuese”.
19. Një kërkesë e tillë, për pezullimin e Udhëzimit Administrativ në të mirë të gjithë pensionistëve të Kosovës, sugjeron që parashtruesi i kërkesës është duke e kontestuar në abstrakt Udhëzimin e lartpërmendur Administrativ. Nëse ky është qëllimi i parashtruesit të kërkesës, ai si individ nuk mund të konsiderohet palë e autorizuar.
20. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës si bazë juridike për parashtrimin e kërkesës. Sidoqoftë, ai nuk ka ofruar ndonjë provë me të cilën do të provonte se ai ka qenë viktimë e drejtpërdrejtë e nxjerrjes së Udhëzimit Administrativ.
21. Vetëm subjektet që në mënyrë të qartë përmenden në nenin 113.2 deri te 113.6 të Kushtetutës, janë palë të autorizuar për të ngritur në Gjykatë çështje të vlerësimit abstrakt të kushtetutshmërisë.
22. Përveç kësaj, sistemi juridiko-kushtetues i Kosovës nuk parashikon *actio popularis* që është modalitet i ankesës individuale me të cilën, individëve që kërkojnë të mbrojnë interesin publik dhe rendin kushtetues, u lejohej të referojnë shkelje në Gjykatën Kushtetuese pa qenë vetë viktimë e shkeljeve të tilla.

23. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtuesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar për të kontestuar në abstrakt kushtetutshmërinë e Udhëzimit Administrativ, dhe rrjedhimisht kërkesa e tij duhet të shpallet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 46, 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (a) dhe (3) (c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 23 shtator 2011, njëzëri

VENDOSI

- i. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- ii. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- iii. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

